

Drejt një sistemi funksional të të Drejtave Pronësore

Të drejtat pronësore duhet të mbrohen pasi që janë gurthemel mbi të cilin ndërtohet një ekonomi e shëndoshë e tregut dhe një qeveri efektive demokratike. Një sistem funksional për mbrojtjen e të drejtave pronësore është i një rëndësie të veçantë për të siguruar sundim të ligjit, kthim të qëndrueshëm, zhvillim ekonomik – duke përfshirë investim të drejtpërdrejt ndërkombëtar – si dhe mbrojtje të interesave të pakicave.

Jose Arraiza dhe Isabel De Blas Mar in, OSBE

Në Kosovë, sistemi i të drejtave pronësore është akoma duke u reformuar. Arkivi ligjor dhe kadastral në lidhje me pronën është ose i mangët ose mungon tërësisht, një numër i madh i ankesave në gjykata nuk janë zgjidhur dhe legjislacioni në lidhje me çështjet pronësore në disa raste është i paqartë dhe i mangët.

Përveq kësaj, për shkak të mosefikasitetit institucional, ndërtimet pa leje nuk regullohen dhe vazhdojnë të lulëzojnë, shtëpitë individuale uzurpohen, toka bujqësore kultivohet ose përdoret në mënyrë jo të ligjshme dhe ekziston një ndjenjë e mosndëshkimit në lidhje me të drejtën pronësore.

Standardi mbi Pronën

Standardi mbi të drejtat pronësore është përpiluar për të ndërtuar në mënyrë strategjike një sistem funksional të të drejtave të njeriut që do të merrte parasysh dhe do të lëvizte drejt zgjidhjes së të gjitha të metave të lartpërmendura. Për ta bërë këtë, Standardi



Prona është problem në tërë Kosovën, Prishtina nuk bën përjashtim si kryeqytet

NË KËTË NUMËR

| | |
|---|-----------|
| Vendbanimet joformale në Kosovë | fq. 3 |
| Konventa evropiane mbi të drejtat e njeriut | fq. 4-5 |
| Intervistë me Marek Antoni Novicki | fq. 6-7 |
| Statusi i pakicave kombëtare | fq. 10-11 |



kërkon të krijohet një legjislacion i plotë, të ketë mekanizma efektiv për zgjidhjen e ngatërresave që kanë të bëjnë me pronën, që pronarët e ligjshëm të pronave banesore, komerciale, dhe bujqësore të mund të marrin pronësi të efektshme të pronës së tyre, dhe një sistem të saktë për transferim, detyrim hipotekor, dhe regjistrim të pronës, si dhe mekanizma efektiv për parandalim të shitjes së pronës në mënyrë të detyrueshme dhe/ose të paligjshme.

OSBE-ja ka qenë e përfshirë në procesin e hartimit të Planit për Implementimin e Standardit të të Drejtave Pronësore, për të marrë më vonë rolin e bashkëkryesuesit të grupit implementues që mbikëqyrë përparimet që bëhen në këtë fushë.


Reforma ligjore

Një nga kërkesat e standardit mbi të drejtat pronësore është kompletimi i një vlerësimi

dhe një plani të veprimit për reformën legjislative që kërkohet për të mbrojtur të drejtat pronësore. OSBE-ja do ta përkrah këtë grup punues në formë të një këshilltari të jashtëm për ekspertizë në “mësimin e mësuar” dhe analiza për ekonomi të ngjashme në tranzicion në rajonin e Ballkanit

Të dhënat e zhvendosura

Një pjesë mjaft e madhe e shënimeve kadastrale dhe ligjore në lidhje me pronën janë larguar nga Kosova dhe dërguar në Sërbi në vitin 1999. Për të rikthyer integritetin e sistemit kadastral dhe gjyqësor, kthimi i këtyre të dhënave është i një rëndësie të veçantë. OSBE-ja ka koordinuar një “qasje të përbashkët” në mes të katër shtyllave për të kërkuar nga autoritetet e Sërbisë dhe Malit të Zi të kthejnë këto të dhëna.



Sven Lindholm

zëdhënës i misionit të OSBE-së në Kosovë

Editoriali me përqëndrim në rolin e përgjithshëm të OSBE-së në çështjen e të Drejtave të Njeriut dhe Shtetit Juridik në pah kontributin e misionit për mbrojtje më të madhe të të drejtave të njeriut dhe shtetit juridik.

Detyra kryesore e OSBE-së në Kosovë është që "të marrë rolin kryesor në çështjet që kanë të bëjnë me ndërtimin e institucioneve dhe demokracisë, të drejtat e njeriut dhe shtetin juridik." Të drejtat e njeriut janë pjesë e ligjit të aplikueshëm, që çojnë deri te dëgjimi rreth përpjekjeve për të bërë legjislacione dhe akte të autoriteteve lokale në përputhshmëri me

të drejtat e njeriut. Por çka do të thotë kjo dhe si ndikon kjo realisht tek njerëzit?

Koncepti i shtetit juridik është më i lehtë që të kuptohet pasi që ndikon siç duket në mënyrë më direkte për shembull kur policët të duken në rrugë ose kur ju e vizitoni gjykatën. Prapëseprapë të drejtat e njeriut dhe shteti juridik janë të gërshetuara mes veti dhe nuk mund të ndahen.

Të drejtat e njeriut janë standard themelor që duhet t'i takojnë çdo personi dhe individi. Kjo përfshinë të drejtën për drejtësi, liri, dhe barazi, të drejtën për shëndetësi, shkollim, strehim, punësim, pronësi, ushqim, liri të të shprehurit dhe lëvizjes. Të shkelësh të drejtat njerëzore të dikujt do të thotë të mos i lejosh personit të ketë dinjitet. Të mbrosh të drejtat e njeriut do të thotë të kërkosh që të respektohet dinjiteti njerëzor i të gjithëve.

OSBE-ja është mbrojtës i të drejtave të njeriut. Detyrat tona përfshijnë monitorimin, ngritjen e kapaciteteve dhe vetëdijes për të drejtat e njeriut. Megjithëse puna jonë çdoherë nuk mund të jetë e dukshme, ne çdo ditë punojmë me administratën komunale dhe profesionistë për çështje ligjore për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë profesionale të tyre për një shërbim më të mirë qytetarëve dhe për një sistem më efikas.

Një shembull i mirë janë përpjekjet që ne i

bëjmë për të ndihmuar sistemin gjyqësor. Misioni i OSBE-së monitoron sistemin gjyqësor dhe në përpjekjet e veta çdoherë përfshinë perspektivën për të drejtat e njeriut. Çështjet më të rëndësishme kanë qenë e drejta për gjykim të drejtë, dhe si gjykatat më të larta të mund të drejtojnë gjykatat më të ulta në mënyrë që ato të marrin vendime ligjore të shëndosha. Kjo ndikon në të drejtat individuale, dhe nëse respektohen ato atëherë sistemi i drejtësisë do të funksionojë më mirë, të drejtat e njeriut do të respektohen dhe shteti juridik do të forcohet.

Raportimi i OSBE-së gjithashtu ka pasur për qëllim të ndikoj tek autoritetet qendrore dhe komunale në përmirësimin e shërbimeve dhe promovoj zhvillimin e institucionit që u shërben të gjithëve pa diskriminim.

Të drejtat gjithashtu mbrohen përmes institucioneve të mirëfillta dhe funksionimit të shtetit juridik. Në fushat e policisë dhe drejtësisë OSBE-ja ndihmon përmes institutit gjyqësor të Kosovës duke trajnuar gjykatës dhe prokurorë, dhe shkolla policore ka krijuar bazën e forcës policore me orientim demokratik.

Por në fund të fundit nuk janë vetë institucionet të cilat mbrojnë të drejtat e njeriut ose sigurojnë kornizën themelore për shtetin juridik. Këtë duhet ta bëjë çdo individ.

vijton nga fq. 1

Ankesat e pazgjidhura pronësore

Zgjidhja e ngatërresave pronësore si pasojë e konfliktit që nuk janë nën mandatin e Drejtoratit për Çështje Pronësore Banësore dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore Banësore, të cilat kanë juridiksion ekskluziv për ankesat mbi pronën banësore si pasojë e konfliktit, është njëra ndër prioritetet e OSBE-së.

Vlerësohet se një numër i ngatërresave për pronë bujqësore dhe komerciale duhet të adresohen nëpërmjet një mekanizmi të veçantë. OSBE-ja ka qenë e përfshirë në kërkimin e një zgjidhjeje e cila do t'i adresonte ngatërresat rreth pronës bujqësore dhe komerciale. Aktualisht, nëpër gjykata të rregullta ekziston një numër i madh i rasteve të pazgjidhura që kanë të bëjnë me pronën. Përafërsisht 20,000 nga këto raste janë të lidhura me konfliktin, dhe nevojitet një zgjidhje strategjike për të përfunduar me sukses këto raste, një numër i të cilave kanë të bëjnë me pronën bujqësore dhe komerciale.

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore

Trashëgimia kulturore kërkon një nivel të veçantë të mbrojtjes. Në Kosovë, një mbrojtje e tillë kërkon masa speciale të drejtuara për të parandaluar dëmtimin dhe ndërtimin e paligjshëm në vende të trashëgimisë kulturore.

OSBE-ja ka qenë e përfshirë në hartimin e propozimeve konkrete për mbrojtje të qëndrueshme të objekteve kulturore. Për

shembull, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së ka lëshuar kohëve të fundit një vendim ekzekutiv që rregullon ndërtime në territorin e Deçanit. Ky vendim mund të shërbej si një model për mbrojtje të objekteve tjera kulturore në të ardhmen.

Në përgjithësi, OSBE-ja është e vetëdijshme për rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave pronësore për të ardhmen e Kosovës dhe punon për të siguruar se përkrahje adekuatë i ofrohet institucioneve lokale.

Uzurpimi – nuk është zgjidhje

Kur një shoqëri a pranon uzurpimin si një mënyrë të pranueshme për zgjidhjen e nevojave ekonomike ose të strehimit, implementimi i legjislacionit mbi pronën bëhet shumë më i vështirë.

Plani për implementimin e standardit mbi pronën përfshin, përveç tjerash, një pikë veprimi e cila adreson këtë brengë. Kjo pikë veprimi kërkon fushatë që do të ndryshonte opinionin publik dhe do të tregonte se uzurpimet nuk janë zgjidhje dhe se duhet të shqyrtohen opionet ligjore.

Me kërkesë të Ministrisë së ambientit dhe planifikimit hapësior dhe zyrës së UNMIK-ut për koordinim të standardeve, Misioni i OSBE-së aktualisht është duke ndihmuar në organizimin e një fushate të tillë me moton: Uzurpimi – nuk është zgjidhje.

Uzurpimi – nuk është zgjidhje

DETAJE

Gazetë e publikuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë

OSCE HQ, Prishtinë / Prishtina, Kosova
Tel: +381 38 500 162, Fax: +381 38 500 188

E-mail: press.omik@osce.org

Web site: www.osce.org/kosovo

Botuesi:

Sven Lindholm

Kryeredaktor:

Nikola Gaon

Redaktorë:

Hasan Sopa, (Detaje)

Slaviša Mladenović (Detalji)

Faqosja:

Shpend Kada

Bashkëpunorët:

Joze Arraiza, Edita Buçaj, Oliver Schmidt-Guzat,

William Henley, Ronald Hooghiemstra,

Rexhep Krasniqi, Fatime Lepaja,

Isabel De Blas Marin, Halide Sadiku,

Mevlyde Salihu, Ardiana Sejdiu, Vasilija Stanić,

OSCE

Mission in Kosovo

Shënim:

Pikëpamjet e paraqitura apo prezantimi i materialeve të botuara nuk shprehin politikën, opinionet apo qëndrimet e misionit të OSBE-së në Kosovë.

Konventa evropjane mbi të drejtat e njeriut një konventë për Kosovën

'Të drejtat' dhe 'Njeriu' janë dy fjalë padyshim të lidhura ngushtë me njëra tjetrën në fjalimet politike në Kosovën e pasluftës. Shumë pak deklarata nga politikanë, administratorë ndërkombëtarë ose diplomatë të huaj bëhen pa përdorur fjalët 'të drejtat e njeriut'. Por, rëndësia e tyre është më shumë se thjeshtë çështje mode. Popullariteti i fjalimeve rreth të drejtave të njeriut në Kosovë, dhe çka është më e rëndësishme, aktivitetet rreth të drejtave të njeriut, janë në masë të madhe pasojë e një dokumenti të njohur fare pak, i nënshkruar 55 vite më parë në Romë të Italisë.

William Henley & Ronald Hooghiemstra

E drejta për jetë

Më 4 nëntor të vitit 1950, shtetet anëtare të Këshillit të posaformuar të Evropës si Belgjika, Franca, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar, u mbledhën në Romë për të shpallur një epokë të re të respektimit të të drejtave të njeriut në Evropë. Nënshkrimi i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale, nuk ka qenë e lehtë duke marrë parasysh historinë e armiqësisë, kundërshtisë dhe luftës në mes të popujve të Evropës. Por, ky dokument, i njohur fare pak, ka pasur efekt shumë të madh në Evropë, dhe çka është më me rëndësi, ndikon në masë të madhe në të ardhmën e Kosovës.

Konventa, e njohur edhe si Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kërkon nga nënshkruesit të përkrahin të drejta të caktuara, si të drejtën për jetë, liri, siguri të personave, liri të lëvizjes dhe liri të shprehjes,

dhe e ndalon torturën, robërinë dhe diskriminimin. Edhe pse shpesh nuk ndryshon shumë nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara të vitit 1948, Konventa ka qenë e rëndësishme për arsye se ka pasur për qëllim të sigurojë njohje efektive dhe respektim të të drejtave të njeriut me ligj.

Gjykata evropiane e të drejtave të njeriut

Në ligjin ndërkombëtar, ka paraqitur konceptin e trupit juridik kolektiv i cili mund të merr vendime për të drejtat e njeriut në secilën prej shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Ky trup juridik, i njohur si Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka autoritet të vendos rreth ankesave të bëra nga individë dhe grupe kur një shtet anëtar i ka shkelur të drejtat dhe liritë e tyre të mbrojtura me Konventë.

Gjykata është e autorizuar të merr vendime rreth veprimeve, ligjeve dhe politikave të një shteti të cilat janë të detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, që tani numëron 46 shtete. Autoriteti i gjykatës mbi ligjet dhe politikat kombëtare është pranur nga të gjitha shtetet evropiane dhe përbën sistemin më të sofistikuar dhe më efektiv të mbrojtjes së të drejtave të njeriut kudo në botë.

E drejta për t'u mbrojtur

Gjatë viteve 1970 dhe 1980, ky sistem i mbrojtjes kolektive ka çuar në qindra vendime nga Gjykata Evropiane, vendime të cilat i obligojnë shtetet të ndryshojnë politikat dhe ligjet e tyre, si dhe të kompensojnë individët dhe grupet për shkeljet e të drejtave të njeriut të përfshira në Konventë. Të gjitha shtetet anëtare kanë respektuar vendimet e gjykatës dhe në shumë raste, shtetet të cilat nuk kanë qenë të përfshira në një rast para gjykatës kanë ndryshuar ligjet dhe politikat e tyre pas dënimit të ndonjë shteti tjetër.

Gjykata Evropiane gjithmonë ka insistuar që shtetet anëtare janë të obliguara të sigurojnë se të drejtat e njeriut janë 'praktike dhe efektive, jo teorike dhe jo iluzioniste'. Sot, shumica e shteteve kanë inkorporuar rregullat e konventës në sistemet e tyre ligjore dhe parimet e të drejtave të njeriut të konventës mund të përdoren para gjyqeve kombëtare për të vënë në praktikë gëzimin e efektshëm të të drejtave të njeriut nga të gjithë.

Zbatueshmëria në Kosovë

Konventa Evropiane dhe Gjykata Evropiane nuk duhet të duken si abstraksione të parëndësishme për jetën në Kosovë. Njerëzit këtu kanë pësuar, dhe nganjëherë akoma pësojnë, shkelje të papranueshme të të drejtave të njeriut. Në bazë të kësaj Korniza Kushtetuese e vitit 2001 është hartuar për t'i ngarkuar qartë autoritetet e Kosovës të respektojnë dhe adresojnë të drejtat e njeriut për të gjithë banorët.

Si të tilla, Institucionet e Përkohëshme Vetëqeverisëse, edhe pse nuk janë nënshkruese të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, janë të obliguara të veprojnë në përputhje me të. Nën nenin 3.2(b) të kornizës,



Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut me seli në Strasbourg të Francës

Intervistë me Ombudspersonin e Kosovës Marek Antoni Novicki

“Kosovës i nevojitet një Ombudsperson që mund të qëndrojë i vetëm, që mund të jetë një strehë dhe katalizator i problemeve të përditshme njerëzore në të ardhmen”

Ombudspersoni i parë dhe sipas gjasave i fundit në Kosovë, Marek Antoni Novicki flet për sfidat gjatë punës së tij. Ai thekson sfidën për Ombudspersonin e ri, i cili sipas tij duhet të jetë një person që e gëzon besimin e tërë popullatës dhe është në gjendje t'i përballojë të gjitha çështjet në mënyrë të vendosur dhe objektive.

Edita Buçaj, OSBE

Institucioni i Ombudspersonit sapo ka publikuar raportin vjetor? Shkurtimisht, si është situata e të drejtave të njeriut në krahasim me vitin e kaluar?

Vlerësimi im i përgjithshëm është se situata është përmirësuar deri në një shkallë. Përgjithësisht, nga këndvështrimi i standardeve minimale të të drejtave të

njeriut, Kosova është ende në nivelin që konsiderohet si minimum. Ka ende çështje, të cilat së paku nga këndvështrimi ynë, janë të rëndësishme vendimtare, siç janë problemet prezente në sistemin ligjor. Kjo situatë mjaft kaotike është theksuar shumë herë në të kaluarën. Tani është pak më mirë, por jo në atë masë sa ta ndryshojmë pozicionin e përgjithshëm.

Nga këndvështrimi i

mbrojtjes elementare të të drejtave të njeriut ne ende e kemi drejtësinë që është mjaft e dobët në disa anë; ekziston një problem i madh në zbatimin e ligjit dhe në zyrat policore dhe të prokurorëve; ka shumë ankesa në lidhje me joefikasitetin e punës së policisë. Nuk mund të flasim për mbrojtjen e të drejtave elementare kur jemi në situatë në të cilën për shembull unë shkoj në fshatrat e caktuara dhe njerëzit më flasin në lidhje me shumë raste të ndryshme, nuk flas për dhunë, po flas për gjërat që janë të vogla por në të njëjtën kohë shumë të rëndësishme për njerëzit, siç janë vjedhjet masive. Kemi vende të ndryshme ku çdo gjë është vjedhur dhe s'ka mbetur asgjë për të vjedhur më. Kur pyesim a ka pasur ndonjë rast të vetëm të gjetjes së autorëve të krimit, ne marrim këso përgjigje: jo, asgjë, zero.


Policia ankohet se nuk i kanë kompetencat për siguri në Kosovë?

Cilat kompetenca? Kompetencat për bastisjen e shtëpisë së ndokujt?

I përmendët problemet në sistemin ligjor. A është kjo për arsye se kemi burime të shumta të legjislativionit?

Në të vërtetë janë burime të shumfishta: ligjet e ish-Jugosllavisë, sistemit të Millosheviqit, rregulloret e UNMIK-ut, ligjet e Kosovës të nxjerrura nga UNMIK-u, standardet ndërkombëtare dhe ligjet e tanishme të Serbisë. Deri në një shkallë të caktuar, këtu kemi një lloj shteti të dyfishtë. Sistemi paralel është mjaft i fortë dhe sistemi i tanishem ligjor i Serbisë është në një mënyrë i pranishëm këtu.

Sa e pengon procesin ky legjislativion i shumëfishtë? Cilat ligje duhen të aplikohen në raste të caktuara?



Klubet për të drejtat e njeriut

Hasan Sopa, OSBE

Në vitin 2002, Misioni i OSBE-së ka filluar me themelimin e Klubeve të të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut. Qëllimi i këtyre klubeve është edukimi i nxënësve të shkollave të mesme, të moshës 14 deri në 18 vjeçare, me të drejtat elementare të njeriut dhe rendësinë e tyre. Tani ekzistojnë nëntë klube aktive për të drejtat e njeriut.

Programi i klubeve për të drejtat njeriut mbështetë anëtarët e klubeve me aktivitete të ndryshme me qëllim të ngritjes së vetëdijes në mesin e popullatës së gjërë për çështjen e të drejtave të njeriut, por gjithashtu edhe forcimin e të kuptuarit të këtyre të drejtave në mesin e anëtarëve të klubeve. Me fjalë të tjera objektivi i programit është hapja e mendjes së të rinjëve për principet bazë për të drejtat e njeriut dhe t'u demonstroj atyre se si të ndër-marrin vetëiniciativa, në mënyrë që ato të jenë të drejta dhe të respektojnë dinjitetin njerëzor të të tjerëve.

Ronald Hugiemstra, shef i seksionit për ngritjen e kapaciteteve në departamentin për të drejtat e njeriut dhe sundimit të ligjit, misioni i OSBE-së në Kosovë shpjegon: "Qëllimi primar i programit është ngritja e aftësive të të rinjëve për t'i kuptuar të drejtat e njeriut dhe ngritjen e tyre përmes debateve të ndryshme, si dhe mbështetja dhe inkurajimi i të rinjëve që mesazhet e tyre t'u dërgojnë komuniteteve të tyre", thotë Hugiemstra.

Me identifikimin e një grupi interesant nga zyrtari në teren, caktohen takime të rregullta javore për 16 javë me radhë. "Atyre kryesisht u ofrohen njohuri për konceptin e të drejtave të njeriut dhe se si këto të drejta ndërliohen me ta", thotë Hugiemstra. Zyrtari në teren gjithashtu organizon debate të ndryshme në mes të grupit dhe i mëson ata si të hartojnë projekt propozime.

Klubi për të drejtat e njeriut nga Prizreni është mjaft aktiv dhe ka organizuar një mori aktivitete, si ekspozitën e fotografive, një koncert për të drejtat e njeriut, debate nëpër shkolla për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut si dhe shumë aktivitete të tjera, të cilat në përgjithësi kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes për të drejtat e njeriut.

Sipas Diana Renda, asistente për të drejtat e njeriut nga seksioni për ngritjen e kapaciteteve, zyra e OSBE-së në Prizren, njëri ndër aktivitete kryesore të këtij klubi ka qenë projekti dedikuar personave me nevoja të veçanta ku është ilustruar pozita dhe kërkesat e tyre në shoqëri.

Anëtarët e klubit të Prizrenit, në bashkëpunim të ngushtë me 'Handikos' nga Prizreni, për disa muaj me radhë kanë vizituar familjet me persona me nevoja të veçanta. "Ata kanë vizituar edhe familjet e fshatrave më të largëta dhe bënë fotografi të tyre për ta ilustruar pozitën e tyre", thotë Renda. Më vonë është bërë zgjedhja e fotografive më të mira dhe është bërë ekspozimi i tyre në insti-

tucionet kryesore publike dhe në disa qendra kryesore të qyteteve për rreth. "Idea kryesore e projektit ka qenë njoftimi i institucioneve tona por edhe qytetarëve në përgjithësi për pozitën e mjerueshme të personave me nevoja të veçanta", thotë ajo.

Elvin Huduti, nga gjimnazi "Gjon Buzuku" në Prizren, është një anëtar i ri i klubit. Ai t'u bashkangjiti klubit para shtatë muajve dhe veç ka marrë pjesë në disa aktivitete të këtij klubi. Ajo që më së tepërmi i pëlqen në klub është puna në grupe dhe respektimi i mendimit të tjerëve.

"Njëra ndër aktivitete që më ka pëlqyer më së shumti ka qenë dokumentari 'Kërko tani të drejtën tënde'. Klubi ynë ka shfaqë dokumentarin në kinemanë e qytetit më 10 dhjetor vitin e kaluar, me rastin e ditës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Aty shfaqeshin sekuenca nga procesi i miratimit të deklaratës universale për të drejtat e njeriut, si dhe fushata të ndryshme që janë organizuar anë a mbanë botës", thotë Huduti.

Aktivitetet e këtilla kanë një ndikim pozitiv në anëtarët e klubit sipas mendimit të Rendës. Kur anëtarët e rinjë regjistruan në klub, zakonisht janë shumë të mbyllur në vetëvete, ngase gjenden në shoqëri me njerëz që nuk i kanë njohur më parë. "Por, në momentin kur fillojmë me aktivitete dhe njoftohen me konceptin për të drejtat e njeriut, janë shumë aktiv dhe fillojnë të shprehën lirshëm. Unë jam shumë e kënaqur kur shoh se si një anëtar i klubit ngritet dhe pa hezitim thotë se nuk pajtohet me mendimin e tjetrit. Kjo nënkupton se ata jo vetëm që angazhohen në mënyrë aktive në sesione por edhe mësojnë gjëra të reja", shprehet ajo.

Bazuar në vlerësimet positive që Misioni ka marrë nga të rinjtë, prindërit, arsimtarët dhe zyrtarët publik, është inkurajuar që të vazhdoj programin. "Mirëpo, me qëllim të një përfshirje sa më të gjërë të të rinëve, sesi ynë do ta zhvilloj këtë aktivitet në një pako

të standardizuar trajnimi dhe metodologjie", thotë Hugiemstra.

Sipas tij, ngritja profesionale e të rinjëve duhet të hyjë nën kompetencat e një institucioni vendor, në mënyrë që të bëhet pjesë e qëndrueshme e kulturës kosovare. "Ajo që ne do të dëshironim është që kjo të bëhet pjesë e një prej institucioneve që merret me çështjet e rinisë si Ministria e Arsimit, Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport apo çfardo institucioni tjetër i përshtatshëm", shton ai.

Edukimi për të drejtat e njeriut

Misioni i OSBE-së gjithashtu bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me qëllim të inkorporimit të edukimit për të drejtat e njeriut në planprogramin e përgjithshëm arsimor.

Me anë të një pilot projekti që është realizuar në vitet 2003 dhe 2004, me qëllim të prezantimit të edukimit për të drejtat e njeriut në klasët e gjashta të shkollave fillore, Misioni ka arritur ta finalizoj një fletore pune për nxënës dhe librin udhëzues për mësues. "Fillimisht ne startuam në 70 shkolla ku kemi trajnuar arsimtarët për metodologjinë e të mësuarit. Mandej kemi monitoruar aplikimin e kësaj metodologjie me nxënës dhe në bazë të rezultateve pozitive që kemi marrë nga vlerësimet që ne bëmë, i kemi propozuar Ministrin të Arsimit. Pas disa ndryshimeve të propozuara nga vetë ministri, ky projekt do filloj të implementohet në klasët e gjashta në të gjitha shkollat e Kosovës", thotë Hugiemstra.

OSBE-ja financiarisht ka mbështetur shtypjen dhe shpërndarjen e 2.000 udhëzuesve për mësues dhe 10.000 fletore pune për nxënës, të cilat konsiderohen si të mjaftueshme për dy vitet e adhsme. Gjithashtu, para fillimit të vitit shkollor 2005-2006 arsimtarëve të këtij niveli mësimor do t'u ofrohet trajnim dhe monitorim adekuat në mësimdhënie, për t'u ndihmuar në dhënjen e një edukimi sa më



Ekspozita e fotografive të personave me nevoja të veçanta organizuar në gjimnazin 'Gjon Buzuku' në Prizren

Statusi i pakicave kombëtare

Pakicat etnike në Kosovë dhe përfshirja e misionit të OSBE-së në mbrojtjen e të drejtave të pakicave

Oliver Schmidt-Gutzat, Senior Advisor on Minority Rights

Mbrojtja e të drejtave të pakicave kombëtare ekziston si pjesë e një sistemi integral të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, e jo ndaras prej tij. Në Evropë, ky parim është i shprehur në Nenin 1 të konventës kornizë të Këshillit të Evropës të vitit 1994 për mbrojtjen e pakicave kombëtare.

Sidoqoftë, sistemi evropian për mbrojtjen e të drejtave të njeriut bën dallim në mes të të drejtave specifike të pjesëtarëve të pakicave kombëtare në njërin anë, dhe të drejtat e përgjithshme të njeriut si dhe parimin e jodiskriminimit në anën tjetër.

Shpesh, por jo gjithmonë, parimi i jodiskriminimit thjeshtë kërkon abstenim të autoriteteve publike nga miratimi dhe aplikimi i masave dhe trajtimi diskriminues ndaj individëve ose grupeve. Në kontrast, të drejta specifike të pakicave (të cilat nuk bën të ngatërrohen me të drejtat veçanta ose shtesë) janë përpiluar me qëllim që t'iu mundësohet pjesëtarëve të pakicave kombëtare të gëzojnë shanse dhe mundësi të barabarta.

Të drejtat e pakicave janë plotësim i domosdoshëm për të drejtën për trajtim të barabartë dhe të drejtat e njeriut të aplikueshme në përgjithësi, siç janë liria e shprehjes, liria e lëvizjes, liria e mbledhjes dhe lidhjes, ose e drejta në pronë.

Të drejtat e veçanta të pakicave dhe liria nga diskriminimi

Të drejtat e veçanta të pakicave kryesisht përfshijnë të drejtat gjuhësore, duke përfshirë të drejtën për përdorim të gjuhëve të pakicave në mediat elektronike, të drejtën për shkollim dhe të drejtën për të marrë pjesë në jetën publike, duke përfshirë vendimmarrjen.

Nga përmbajtja e këtyre të drejtave është e qartë se abstenimi nga sjellja diskriminuese nuk është e mjaftueshme. Përveç të drejtës për trajtim të barabartë, kërkohet edhe miratim dhe implementim i rregulloreve ose masave për diskriminim pozitiv ose veprim afirmativ. Implementimi i tyre garanton se pjesëtarët e pakicave kombëtare gëzojnë mundësi të barabarta.

Qëllimi i të drejtave të veçanta të pakicave është i dyfishtë: të saktësojë të drejtën e secilit person të ruajë dhe zhvillojë identitetin, dhe të lehtësojë integrimin, joasimilimin,



Ambasadori Werner Wnendt me stafin e tij dëgjojnë më vëmendje për brengat e pakicave kombëtare në një vizite në fshatin Bellopojë të Pejës

e pakicave kombëtare në shoqëri. Qëllimi i parë buron nga parimi se "të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta medijet dhe të drejta," siç është e shkruar në nenin 1 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me 10 dhjetor 1948.

Situata në Kosovë

Në Kosovë, UNMIK-u dhe Institucionet e Përkohëshme Vetëqeverisëse (IPVQ) gjatë viteve të fundit kanë miratuar një numër të ligjeve dhe rregulloreve në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pakicave dhe anti-diskriminimit. Shumë nga këto të drejta e kanë gjetur rrugën në Planin për Implementimin e Standardeve dhe kështu kanë kontribuar në një vetëdije të shtuar brenda IPVQ-së dhe në mesin e popullatës shumicë të Kosovës.

Është arritur progres, edhe pse shumë ngadalë, në zbatimin e këtyre të drejtave. Themelimi kohëve të fundit i Ministrisë së Kthimit

dhe Komuniteteve, përpjekjet e IPVQ-së për të rritur numrin e pjesëtarëve të pakicave që punojnë nëpër ministri, dhe trajtimi i parë nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për gjuhën serbe, i përkrahur nga OSBE-ja, për shërbyesit civil nga Rahoveci, janë vetëm disa nga shembujt e veprimit afirmativ nga institucionet e Kosovës.

Një shembull tjetër pozitiv i veprimit afirmativ ka për qëllim integrimin e grupeve tradicionale më të ndieshme dhe të lëna anash në Kosovë, romët dhe ashkalinjtë, në rrjedhat e përgjithshme të shkollimit. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në bashkëpunim me OSBE-në, ka zbatuar gjatë vitit të kaluar shkollor orë të përshpejtuara mësimi për fëmijët romë dhe ashkali në tetë komuna të Kosovës. Megjithatë, një strategji e përgjithshme e IPVQ-së për përmirësimin e gjendjes së romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasëve e cila do të përfshinte, përveç të tjerave, edhe vendbanimet joformale dhe strehimin, regjistrimin, shkollimin, shëndetësinë dhe punësimin, akoma nuk është përpiluar.

Dhuna në familje dhe trafikimi i qenieve njerëzore

probleme serioze që kërkojnë zgjidhje gjithëpërfshirëse

Hasan Sopa dhe Nikola Gaon, OSBE



Sesioni i Trajnimit të Trajnerëve për dhunën në familje, organizuar nga zyra e OSBE-së në Gjilan

Problemi i trafikimit me qenie njerëzore dhe dhunës në familje është mjaft brengosës në Evropën Juglindore. Gjersa dhuna në familje ka ekzistuar historikisht, çështja e trafikimit të qenieve njerëzore është diçka e re në Kosovë. Pas konfliktit të vitit 1999, Kosova kryesisht ishte vend i destinacionit të trafikimit të viktimave të moshës madhore dhe asaj të mitur. Kohët e fundit janë duke u regjistruar edhe rastet e trafikimit të grave dhe fëmijëve nga Kosova.

Misioni i OSBE-së në Kosovë merret me të dy këto probleme. Bën monitorimin e punës së institucioneve vendore dhe të UNMIK-ut dhe ofron këshilla dhe ndihmesë teknike sipas nevojës. Herë pas here merret edhe me raste të veçanta për të identifikuar boshllëqet në shërbimet ekzistuese dhe ndihmon në adresimin e këtyre boshllëqeve me anë të ndërtimit të institucioneve dhe avancimin e kapaciteteve ekzistuese.

Vlenë të theksohet se misioni i OSBE-së është duke punuar në krijimin e mekanizmave gjithëpërfshirës për mbrojtjen e viktimave të dhunës seksuale dhe me bazë gjinore, viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore dhe abuzimit të fëmijëve. Për krijimin e këtyre mekanizmave Misioni bashkon akterët kryesor si: Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Zyrën e Kryeministrit, Departamentin e Drejtësisë, Departamentin për Mirëqenie Sociale, Njësitin kundër Dhunës në Familje të Policisë së UNMIK-ut, Policinë e UNMIK-ut Sektorin për Hulumtimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Organizatën Ndërkombëtare për Migrim, Zyrat e Ko-

munal për Çështje Sociale, shoqatat që ofrojnë strehim për viktimat, OJQ-të si dhe organizatat tjera relevante vendore dhe ndërkombëtare.

Qëllimi kryesor është që t'u mundësohet viktimave qasje më e lehtë në mekanizmat e drejtësisë, si mbështetje ligjore dhe forma të asistencës së drejtpërdrejt dhe të sigurohet rehabilitimi dhe integrimi i tyre në shoqëri.

Këshilla dhe aktivitetet trajnuese

Misioni i OSBE-së u sugjeron institucioneve qëndrore në hartimin e politikave në përputhshmëri me ligjet e aplikueshme dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në anën tjetër bën ngritjen e aftësive profesionale të institucioneve vendore në të gjitha nivelet, me anë të trajnimeve dhe mbështetjes teknike. Qëndrueshmëria e strukturave qeverisëse të cilat merren me mbështetjen e viktimave të dhunës seksuale dhe me bazë gjinore është njëra prej prioritetëve kryesorë në këtë fushë.

Bashkëpunimi i OSBE-së me Zyrën për Qeverisje të Mirë nga Zyra e Kryeministrit ka ndihmuar në zhvillimin e Planit të Kosovës për Veprim Kundër Trafikimit (PKVKT), i cili plan është aprovuar nga qeveria më 17 maj 2005. Këshilltarja vendore për dhunën në familje dhe luftimin e trafikimit, Ariana Qosaj-Mustafa, e dërguar nga misioni i OSBE-së në Zyrën e Kryeministrit ka ndihmuar këtë proces që nga fillimi.

Sipas Jenifer Qeis, këshilltare e lartë në misionin e OSBE-së për të drejtat e njeriut,

PKVKT-ja është një plan gjithëpërfshirës që i adreson çështjet që kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerëzore në fushat e parandalimit, mbrojtjes dhe ndjekjes penale. "OSBE-ja ka ofruar mbështetje teknike dhe financiare gjatë procesit të hartimit të dokumentit. OSBE-ja do të mbetet pjesë e bordit këshilldhënës, siç është paraparë në PKVKT, dhe do të vazhdoj të ofroj eksperizë teknike dhe monitoroj implementimin e planit nga organet legjislativë dhe ekzekutive vendore", thekson Qeis.

Procedurat për operimin e standardeve

Para kompletimit të PKVKT-së në fund të vitit 2004, Misioni ka ndihmuar formimin e Procedurave për Operimin e Standardeve (POS) për t'u dalë në ndihmë viktimave të huaja të trafikimit. Procedura të ngajshme operative për t'u ofruar ndihmë viktimave kosovare janë në proces të formimit gjithashtu.

Sipas Qeis POS-ja tregon se sa i suksesshëm është koordinimi i shërbimeve të kundër trafikimit që mund t'u referohen mekanizmave që punojnë në interesin më të mirë të viktimës. "Ne kemi ndihmuar grupin punues të quajtur 'Asistenca Direkte' për formimin e POS-së. POS-ja përbën pjesën e përpjekjeve për themelimin e një sistemi i cili shton transferimin e kompetencave në Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes si dhe akterëve të tjerë relevant civil të Kosovës me qëllim të krijimit të një mekanizmi të qëndrueshëm për mbrojen e viktimave", thotë ajo.

Trainime gjithëpërfshirëse

Formimi i PKVKT-së dhe POS-së nuk është i mjaftueshëm. Ata të cilët merren me çështjen e dhunës në familje dhe trafikimit, duhet të trajnohen se si t'i përdorin këta mekanizma gjithëpërfshirës dhe të sigurojnë një bashkëveprim të të gjitha organeve të involvuara.

Për këtë shkak, nga janari deri në prill 2005, Misioni me partnerët e tij kanë mbajtur pesë trajnime regjionale për procedurat e operimit të standardeve për asistencë dhe mbështetje direkte viktimave të huaja të trafikimit, si në Prizren, Pejë, Gjilan, Prishtinë dhe Mitrovicë. Në këto trajnime treditore morën pjesë rreth 35 pjesëmarrës nga secili regjion dhe në mesin e tyre kanë qenë

Ekspertët për të drejtat e njeriut punojnë për ju

Intervistë me Asier Santillan Luzuriaga, këshilltar i lartë për të drejtat e njeriut pranë misionit të OSBE-së.

Mandati i misionit të OSBE-së në Kosovë është ngritja e institucioneve vendore të nivelit qendror dhe lokal, si dhe promovimi i respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Nikola Gaon, OSBE

Me qëllim të kontaktimit më të lehtë me institucione dhe të veprimit të shpejtë, Misioni lansoi programin për Ekspertë të Drejtave të Njeriut (EDNJ). Nën këtë program, ekspertët e OSBE-së për të drejtat e njeriut kryejn punën e tyre të vendosur në komuna dhe në stacionet policore anë e mbanë Kosovës, dhe u ndihmojnë zyrtarëve lokal. Këta ekspertë tani janë këshilltarë të kryeshefave të ekzekutivëve në komuna dhe komandantëve të zyrave të policisë.

Asier Santillan Luzuriaga, këshilltar i lartë i OSBE-së për të drejtat e njeriut, i cili ka punuar si ekspert për të drejtat e njeriut në Lipjan, tani së bashku me kolegën e tij, Nora Benvakob, koordinojnë punën e 16 EDNJ-ve, të vendosur në 16 komuna të Kosovës. Në këtë intervistë, ai tregon për përvojën e tij si dhe hedh më tepër dritë për ndikimin e programit dhe sfidat kryesore.

Cilat janë arsytet kryesore për lansimin e këtij programi?

Programi për ekspertë të të drejtave të njeriut u lansua si rezultat i politikës së OSBE-së për t'i përshtatur aktivitetet e saj me nevojat e shoqërisë kosovare. Në mes të vitit 1999 dhe 2001, ne kemi monitoruar të gjitha aspektet e mundshme të të drejtave të njeriut në një shoqëri post-konfliktuale nën administrimin e Kombeve të Bashkuara. Të gjithë zyrtarët tanë për të drejtat e njeriut kishin njohuri të përgjithshme. Strukturat e IPVQ-së u krijuan pas zgjedhjeve të para të vitit 2000, pastaj autoritetet vendore morën përgjegjësitë në mënyrë graduale. Gjatë asaj kohe, ne e ndryshuam sistemin e punës duke i drejtuar aktivitetet tona 'mbikqyrëse' tek strukturat e reja, duke e harruar qasjen e përgjithshme dhe duke u koncentruar më shumë në çështjet më specifike dhe më të specializuara. Në vitin 2003, Kosova filloi të lëvizë drejt definimit të statusit të saj dhe ne vendosëm, tani për herë të dytë, që ta ndërrojmë qasjen tonë dhe të fokusojmë aktivitetet dhe përpjekjet tona drejt ngritjes së kapaciteteve të IPVQ-së. Qëllimi i ynë është që standardet duhet të kuptohen nga administrata para se ato të implementohen. Ne duam të ofrojmë këshilla me qëllim që të sigurojmë se legjislacioni dhe aktivitetet e IPVQ-së janë në pajtim me standardet ndërkombëtare, esidomosato europiane, për të drejtat e njeriut.

Pas aplikimit njëvjeçar të pilot projekteve nëpër të gjitha komunat e Kosovës, kriteret e

programit u nënshkruan nga ish-ambasadori Pascal Fieschi dhe ministri i administratës lokale, Lutfi Hazri, i cili atëherë ishte kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës. Në dhjetor të vitit 2004, ne lansuam një strategji të përgjithshme e cila ishte e fokusuar në çështjet e jo-diskriminimit dhe të pronës.

Sa është shpërndarë ky program dhe çfarë perspektive do të ket në të ardhmen?

Tani për tani, programi mbulon 16 komuna. Ne kemi marrë vendim që të reduktojmë aktivitetet tona në vetëm pesë sosh, ato të cilat kanë përfituar nga prania e EDNJ-ve për së paku një vit e gjysmë, por ne jemi duke planifikuar që ta shtrijmë programin edhe në komuna tjera. Qëllimi ynë është që t'i mbulojmë shumicën e 30 komunave të Kosovës deri në fund të këtij viti.

Si do të operojnë, dhe pse ata nuk mund të ndajnë vështrimet me publikun në përgjithësi?

Përveç zyrtarëve ekzekutiv, EDNJ-të punojnë së bashku me zyrtarët e IPVQ-së dhe identifikojnë problemet sistematike që kanë ndikim në mbrojtjen e të drejtave të njeriut brenda komunës. EDNJ-të japin këshilla dhe rekomandime se si të zgjidhen ato probleme, dhe sipas nëvojës organizojnë aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve dhe seminare për shërbyesit civil.

EDNJ-të nuk kanë pushtet ekzekutiv dhe nuk mund të imponojnë

rekomandime. Mënyra e vetme që autoritetet vendore të implementojnë propozimet tona është që ata të jenë në anën tonë. Ata duhet ta kuptojnë se ne jemi një ekip punues. Autoritetet komunale duhet të ndihen sikur janë pronarë të këtyre rekomandimeve. Në këtë aspekt, EDNJ-të kanë dy mjete të ndryshme. I pari është shpirti bashkëpunues i programit që reflektohet në mbledhjet e rregullta me akterë të ndryshëm ku çështjet diskutohen hapazi, dhe e dyta është besueshmëria. Të gjitha diskutimet brenda komunës duhet të jenë konfidenciale dhe mund të mos raportohen publikisht. Qytetarët mund të përfitojnë mjaft nëse autoritetet komunale punojnë në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut. Duhet kohë për ndërtimin e partneritetit me autoritetet komunale dhe ne nuk duam që të rrezikojmë rezultatet e tilla të mundshme, si dhe mundin për hirë të raportimit.

Çfarë rezultatesh priten dhe si e vlerësoni implementimin e tyre, pra kur konsiderohet se programi është implementuar?

Mandati ynë kryesor është që të ndërtojmë një kapacitet të brendshëm, afatgjatë dhe të vetëqëndrueshëm të të drejtave të njeriut në qeveritë lokale, kapacitet që do të përqafohet nga të



Forcimi i rolit të rinisë një sfidë për të ardhmën

Njëra ndër prioritetet kryesore të misionit të OSBE-së në Kosovë është përfshirja e rinisë në të gjitha aspektet e jetës shoqërore. Sepse puna me të rinjtë mendohet të jetë më frytëdhënëse dhe më e qëndrueshme.

Këtë e ilustron më së miri edhe bashkëpunimi i ngushtë në mes të zyrës regionale të OSBE-së në Pejë me organizatën rinore 'Rrjeti i të Rinjëve të Pejës'. Rezultatet e këtij bashkëpunimi e dëshmojnë këtë më së miri.

Rrjeti i të rinjëve të Pejës (RrRP) u formua në prill të vitit 2002 me iniciativën e marrë nga zyra regionale e OSBE-së në Pejë. Vlen të theksohet se dëshira e madhe për themelimin e këtij rrjeti ishte edhe në mesin e shtatë anëtarëve të qendrave dhe OJQ-të rinore të komunës së Pejës të cilat edhe janë themeluesë të këtij rrjeti.



Rrjeti i të rinjëve nga Peja duke shpërndarë fletushka në qytetin e Pejës.

Projektet me karakter shumetnik

RrRP-ja është organizatë që në vete përmban të rinjë nga komunitetet që jetojnë në komunën e Pejës si shqiptarë, serbë, boshnjakë, egjiptas dhe romë. Të gjithë përfaqësues të rrjeteve të OJQ-ve dhe qendrave rinore të cilat realizojnë aktivitete të shumta si dhe implementojnë projekte të ndryshme me theks të veçantë në ato me karakter shumetnik.

Hysen Pelaj, zyrtar vendor për zhvillimin e demokracisë pranë zyrës së OSBE-së në Pejë shpjegon; "Gjatë realizimit të projekteve, gjithmonë i është dhënë rëndësi e veçantë përbërjes shumetnike, bazisë gjinore dhe shtrirjes së aktiviteteve në hapsirat urbane dhe rurale".

Sipas Vlora Latifit, koordinatore e RrRP-së një projekt i këtillë ka qenë Trajnimi për Trajner, që është mbajtur në Kotorr, Mal të Zi në prill të vitit 2004. Trajnimi u organizua nga zyra e OSBE-së në Pejë, ku edhe është formuar Njësia e Trajnerëve të Rrjetit.

"Kjo njësi tani ka 17 trajner, dhe përbëhet nga përfaqësues të të gjitha komuniteteve" thotë ajo. Të gjithë trajnerët kanë kaluar nëpër trajnime të ndryshme si trajnime për menaxhimin e konflikteve, barazi gjinore, të drejtat e njeriut, dialog ndëretnik dhe planifikim strategjik dhe u kan ndihmuar atyre t'ua përcjellin këto njohuri gjeneratave të reja.

Përvojat e përfituara nga trajnimet

Zyliha Kuqi koordinatore e njësies së trajnerëve të RrRP-së ka qenë e entuziazmuar që nga fillimi me punën e rrjetit. Ajo vazhdon të mbaj trajnime në tri rrjetet rinore të Klinës, Deçanit dhe Istogut.

Gazmir Raci, pjesmarrës i këtyre trajnime e vlerëson lartë projektin dhe punën e Rrjetit. "Sipas mendimit tim, trajnimet e ofruara nga Rrjeti janë jo vetëm një mundësi për afrimin e të rinjëve të komuniteteve të ndryshme në regionin e Pejës, por ato ndihmojnë edhe në ngritjen e kapaciteteve të tyre për të kuptuar më mirë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre", thotë ai.

Sipas z. Pelaj, gjatë periudhës tre vjeçare me projekte të ndryshme të financuara nga OSBE-ja, është arritur shumë në kapërcimin e paragjykimëve dhe stereotipeve që kishin të rinjtë e komuniteteve të ndryshme për njëri tjetrin si pasojë e problemeve të së kaluarës. "Hapa të rëndësishëm janë bërë posaqërisht në afrimin e të rinjëve shqiptar dhe serb në rajonin tonë, ndonëse kjo ende mbetet një sfidë për të ardhmën", shprehet Pelaj.

Aktivitetet për të ardhmën

'Iniciativa e të Rinjve për Ripajtim 2005' është projekt që financohet nga OSCE-ja dhe RrRP-ja ka filluar ta implementoj në prill të këtij viti. "Është një projekt nëntë mujorë që për qëllim ka fuqizimin e rinisë dhe njëkohësisht ripajtimin e të rinjve të komuniteteve të ndryshme", thotë Latifi. "Projektin do ta realizoj Rrjeti Rinor i Pejës dhe do t'ua ofrohet të gjitha organizatave rinore të regjionit".

Sipas saj ekzistojnë një mori aktiviteteve që pritet të realizohen gjatë këtij viti e që janë pjesë e projektit Iniciativa e të Rinjve për Ripajtim 2005. "Këtu bën pjesë fushata mbi standardet në Kosovë, ambientin, si dhe fushata për tolerancë, të cilat do të implementohen në të gjitha qytetet e regjionit të Pejës" shprehet Latifi.

Si Aktivitetet tjetër që vlen të përmendet është edhe Trajnimi për Trajner, që do të mbahet në fund të muajit korrik dhe përfitues drejtpërdrejt do të jenë të rinjtë e rrjeteve Klinë Deçan si dhe Istog,

"Si pjesë e këtij projekti, Rrjeti Rinor i Pejës së bashku me Rrjetet Rinore të Klinës, Deçanit, dhe Istogut do të mbajnë takimin vjetor mbi strategjinë e këtyre katër rrjeteve për vitin 2006, ku për 3 ditë me radhë do të punohet për planin e veprimit për vitin 2006", thotë Latifi.

"Për të mbajtur shënime të punës së tyre dhe për të mësuar nga përvojat e akumuluar, Rrjeti Rinor i Pejës do të përpiloj raportin përfundimtar vjetor në formë të një doracakut, ku do të paraqitet e gjithë puna e bërë gjatë vitit 2005 e që mund të përdoret edhe nga rrjetet tjera rinore", përfundon Latifi.



Një grup tjetër i Rrjetit të të rinjëve të Pejës gjatë një trajnimi